

## UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 20, datë 20.9.2019

### PËR SKEMËN DHE ZBATIMIN E MODELIT TË FINANCIMIT TË INSTITUCIONEVE PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË DHE KËRKIMIN SHKENCOR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të pikës 3, të nenit 110, të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe vendimit nr. 75, datë 12.2.2018 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”, ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe ministri i Financave dhe Ekonomisë,

UDHËZOJNË:

#### KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Financimet në formë granti për institucionet publike të arsimit të lartë dhe kërkimin shkencor, miratohen nga ministria përgjegjëse për arsimin, sipas kuotave dhe kritereve të përcaktuar me vendimin nr. 75, datë 12.2.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”, në përputhje me kushtet dhe qëllimet e grantit të miratuar, sipas skemës sa vijon;

a) granti i politikave të zhvillimit për institucionet publike të arsimit të lartë, në programin 09450, kapitulli 01 artikulli 230–231;

b) granti i mësimdhënies, në programin 09450, kapitulli 01, artikulli 604;

c) granti i punës kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese, në programin 09770, kapitulli 01, artikulli 604-230-231.

2. Detajimi i fondeve, sipas strukturës buxhetore për të gjitha njësitë shpenzuese përfituese të fondeve grant, dërgohet nga nëpunësi autorizues i ministrisë përgjegjëse për arsimin, pranë nëpunësit të parë autorizues për miratim, zyrtarisht dhe në formë elektronike. Pas miratimit, struktura përgjegjëse në ministrinë përgjegjëse për arsimin, regjistron këtë detajim në sistemin financiar (SIMF).

#### KREU II SKEMA E MIRATIMIT DHE E ZBATIMIT TË FONDEVE “GRANTI I POLITIKAVE TË ZHVILLIMIT” PËR INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË

1. Granti i politikave të zhvillimit për institucionet publike të arsimit të lartë, përfshin:

a) fondin për mbështetjen e institucionit dhe infrastrukturës akademike;

b) fondin e projekteve konkurruese për zhvillimin e institucioneve të arsimit të lartë.

2. Fondi për mbështetjen e institucionit dhe infrastrukturës akademike shpërndahet mbi bazën e renditjes së institucioneve publike të arsimit të lartë, të kryer nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI).

3. Fondi i projekteve konkurruese për zhvillimin e institucioneve publike të arsimit të lartë shpërndahet mbi bazën e projekteve që ato paraqesin, sipas kritereve të përcaktuara në strategjitë sektoriale dhe në ligjin vjetor të buxhetit.

4. Ministri përgjegjës për arsimin, miraton prioritetet, temat e shpërndarjes, formën e aplikimit për grantin, si dhe miraton grantin e politikave të zhvillimit të institucioneve publike të arsimit të lartë, mbi bazën e aplikimit apo të prioriteteve strategjike të zhvillimit të vendit.

5. Fondet e miratuara “grant i politikave të zhvillimit të institucioneve publike të arsimit të lartë”, përparësi në financim do të kenë:

a) projektet në vazhdim nga viti paraardhës ose më parë;

b) projektet e propozuara/ miratuara për financim gjatë vitit ushtrimor, mbi bazën e aplikimit apo të prioriteteve strategjike të zhvillimit të vendit;

c) detyrimet për TVSH ose bashkëfinancimet nga fonde grant për projektet me financim të huaj, do të financohen në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet financiare të projekteve dhe në përputhje me vlerën e financimit të huaj të planifikuar për vitin ushtrimor;

d) financimi i projekteve të reja të propozuara për financim, të shqyrtuara nga Këshilli i Ministrave dhe të paraqitura në Kuvend, për vitin ushtrimor.

6. Fondet e miratuara në formë “granti i politikave të zhvillimit”, në programin buxhetor 09450, kapitullin 01, artikulli 230-231, rishpërndahen sipas projekteve me përfitues institucionet publike të arsimit të lartë, në përputhje me përcaktimet e bëra në ligjin vjetor të buxhetit dhe/ose ligjit të arsimit të lartë, në programin buxhetor 09450, kapitullin 01, artikulli 230-231.

7. Institucionet publike të arsimit të lartë, financojnë ose bashkëfinancojnë, nga të ardhurat e tyre, projekte për rritjen dhe/ose përmirësimin e kapaciteteve të infrastrukturës akademike, si dhe projekte për zhvillimin e institucioneve.

### KREU III

#### SKEMA E MIRATIMIT DHE E ZBATIMIT TË FONDEVE “GRANTI I MËSIMDHËNIES” PËR INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË

1. Granti i mësimdhënies përfshin:

a) fondin për institucionet publike të arsimit të lartë, në masën jo më pak se 90%;

b) fondin e mbështetjes studentore, në masën deri në 10% në vit.

2. Fondi institucional u shpërndahet institucioneve publike të arsimit të lartë, sipas një formule të miratuar me vendimin nr. 75, datë 12.2.2018, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”.

3. Fondi i mbështetjes studentore miratuar në formë granti, përfshin tri kategori financimi:

a) bursat e studimit për studentët e shkëlqyer;

b) bursat e studimit për studentët në programet e studimit që përbëjnë prioritet kombëtar;

c) bursat e studimit për studentët që u përkasin shtresave sociale në nevojë.

4. Institucionet publike të arsimit të lartë, për një periudhë kalimtare dy deri në tre vjet, në përlogaritjen e formulës për masën e financimit, bazuar në nevojat/kërkesat e tyre specifike do të rivlerësohen, ekualizohen dhe financohen me një fond shtesë.

5. Fondet e miratuara në formë “granti për mësimdhënie për institucionet publike të arsimit të lartë”, në programin buxhetor 09450, kapitullin 01, artikulli 604, miratohen dhe rishpërndahen nga ministria përgjegjëse për arsimin për përfitues institucionet publike të arsimit të lartë.

6. Fondet e miratuara në formë “granti për mësimdhënie për institucionet publike të arsimit të lartë”, shpërndahen me vendim të Bordit të Administrimit, në programin buxhetor 09450, kapitulli 08, artikulli 600–606, mbështetur në objektivat institucionalë të IAL publike, si dhe në propozimin e Senatit Akademik, sipas tabelave model nr. 1 dhe nr. 2, të cilat dërgohen zyrtarisht dhe në formë elektronike në ministrinë përgjegjëse për financat për t’u regjistruar në sistemin informatik financiar (SIFQ) dhe për dijëni në ministrinë përgjegjëse për arsimin.

7. Institucionet publike të arsimit të lartë, financojnë apo bashkëfinancojnë nga të ardhurat e tyre, fonde për mësimdhënie, për blerje materiale dhe shërbime, si dhe mbështetje financiare për studentë.

8. Përdorimi i fondeve publike nga Buxheti i Shtetit për institucionet publike të arsimit të lartë, bëhet në përputhje me kushtet dhe qëllimet e grantit të miratuar.

### KREU IV

#### SKEMA E MIRATIMIT DHE E ZBATIMIT TË FONDEVE “GRANTI I PUNËS KËRKIMORE-SHKENCORE DHE I VEPRIMTARIVE KRIJUESE”

1. “Granti i punës kërkimore-shkencore dhe i veprimtarive krijuese” përfshin fondet për kërkimin shkencor, të miratuar me ligjin vjetor të buxhetit në programin 09770, kapitulli 01, artikulli 604, dhe artikulli 230-231.

2. Ky grant është i hapur, për konkurrim/aplikim për të gjitha institucionet e arsimit të lartë të akredituara që zhvillojnë kërkim shkencor.

3. Institucionet e arsimit të lartë të llojit universitet dhe akademi, aplikojnë për të përfituar nga ky grant dhe për financimin e studimeve të doktoratës.

4. Nga ky fond përjashtohet financimi i ngarkesës së pedagogëve për udhëheqjen e doktoratës.

5. Vlerësimi i cilësisë së kërkimit shkencor përbën kriterin bazë të renditjes së institucioneve të kërkimit shkencor nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit dhe përcaktimin e masës së financimit, të përfituar nga Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë, për IAL-të publike.

6. Institucionet e kërkimit shkencor, marrin masa për vlerësimin dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë, nëpërmjet njësisë përkatëse, përbërja dhe funksionimi i së cilës përcaktohen në statutin dhe rregulloren e institucionit përkatës.

7. Skema për miratimin dhe shpërndarja e fondeve të kësaj kategorie të miratuara në formën “Granti i punës kërkimore-shkencore dhe i veprimtarive krijuese”, realizohet nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), mbi bazën e projekteve që institucionet paraqesin dhe duke mbajtur në konsideratë treguesit kryesore për projektet kërkimore-shkencore dhe veprimtarinë krijuese të IAL-ve të miratuar me vendimin nr. 75, datë 12.2.2018 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”.

8. Fondet e miratuara me ligjin vjetor të buxhetit “Granti i punës kërkimore-shkencore dhe i veprimtarive krijuese”, në programin buxhetor 09770, kapitullin 01, artikulli 604, rishpërndahet me vendim të Bordit të Administrimit të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), me përfitues institucionet e arsimit të lartë, të akredituara, që zhvillojnë kërkim shkencor, në programin buxhetor 09770, kapitulli 08, artikulli 602–606. Vendimi i bordit, së bashku me tabelat shoqëruese të detajimit të buxhetit, dërgohen zyrtarisht, si edhe në formë elektronike në ministrinë përgjegjëse për financat për t’u regjistruar në sistemin informatik financiar (SIFQ) dhe për dijeni në ministrinë përgjegjëse për arsimin.

## KREU V DISPOZITA TË FUNDIT

1. Fondet e buxhetit të shtetit të miratuara në formë granti apo në formë “transfertë e pakushtëzuar” për “Shoqëritë e Trajtimit të Studentëve” sh.a., në Tiranë dhe në rrethe, paguhen në llogarinë bankare të përfituesit nga struktura përgjegjëse për thesarin me urdhër të njësisë së qeverisjes së përgjithshme dhënëse, dhe me paraqitjen nga kjo e fundit të dokumenteve justifikuese të shpenzimit (situation, fatura, listëpagesa).

2. Kompetencat dhe funksionet e Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë, do të ushtrohen nga ministria përgjegjëse për arsimin, deri në momentin e ushtrimit të plotë të funksioneve dhe komepetencave nga Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë.

3. Fondet e përfituara në formë granti nga institucionet publike të arsimit të lartë dhe të papërdorura në fund të vitit financiar në përputhje me rregullat dhe standardet e menaxhimit financiar publik, trashëgohen në vitin pasardhës.

4. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT  
DHE RINISË  
**Besa Shahini**

MINISTËR I FINANCAVE  
DHE EKONOMISË  
**Anila Denaj**

## FONDET GRAND TË DETAJUARA DHE TË MIRATUARA PËR IAL-të PUBLIKE

Tabela nr. 1. Fondet e miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin, për vitin financiar.										
Kodi i qeverisjes	Ministria e linjës	Institucioni	Kapitulli	Programi	Llogaria ekonomike	Kodi i qarikut	Kodi i produktit	Emërtimi i produktit	Fondet e detajuara për vitin ushtrimor, në lekë	Aktivitete të përfshira për të realizuar këtë produkt
001	11	1011136	01	09450	6040000	3737	91105 AA	Studentë që ndjekin ciklin e parë të studimeve	X1	Fonde grant për mësimdhënie në IAL publike, shpenzime të personelit, etj., korrente. Fondet Detajohen me Vendim të Bordit Administrimit
001	11	1011136	01	09450	6040000	3737	91105 AA	Studentë që përfitojnë bursa financiare si dhe mbështetje financiare të studentëve	X2	Fonde grant për mësimdhënie në IAL publike, shpenzime për bursa financiare për studentët. Fondet Grant detajohen me Vendim të Bordit të Administrimit
001	11	1011136	01	09450	2310000	3737	M1126 92	Projekte për zhvillimin institucional	X3	Fonde Grant për Projekte për zhvillimin institucional
001	11	1011136	01	09770	2310000	3737	M1127 00	Fonde Granti për projekte të punës kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese.	X4	Fonde Granti i punës kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese
<b>Totali</b>									<b>Tot=x1+x2+x3+x4</b>	

Tabela nr. 1/8. Fondet e shpërndara me vendim të Bordit të Administrimit për vitin ushtrimor, me burim financimi fondet grant, nga Buxheti i Shtetit për IAL-të publike, të cilat miratohen, sipas strukturës sa vijon:										
Kodi i qeverisjes	Ministria e linjës	Institucioni	Kapitulli	Programi	Llogaria ekonomike	Kodi i qarikut	Kodi i produktit	Emërtimi i produktit	Buxheti i detajuar për vitin ushtrimor në lekë	Aktivitete të përfshira për të realizuar këtë produkt
001	11	1011136	08	09450	6000000	3737	91105A A	Studentë që ndjekin ciklin e parë të studimeve	X1	Fonde grant për mësimdhënie në IAL publike, shpenzime të personelit, etj., korrente. Fondet detajohen me Vendim të Bordit të Administrimit
001	11	1011136	08	09450	6010000	3737	91105A A	Studentë që ndjekin ciklin e parë të studimeve	X1	Fonde grant për mësimdhënie në IAL publike, shpenzime të personelit, etj., korrente. Fondet detajohen me Vendim të Bordit të Administrimit
001	11	1011136	08	09450	6020000	3737	91105A A	Studentë që ndjekin ciklin e parë të studimeve	X1	Fonde grant për mësimdhënie në IAL publike, shpenzime të personelit, etj., korrente. Fondet detajohen me Vendim të Bordit të Administrimit
001	11	1011136	08	09450	6050000	3737	91105A A	Studentë që ndjekin ciklin e parë të studimeve	X1	Fonde grant për mësimdhënie në IAL publike, shpenzime të personelit, etj., korrente. Fondet detajohen me Vendim të Bordit të Administrimit
001	11	1011136	08	09450	6060000	3737	91105A A	Studentë që ndjekin ciklin e parë të studimeve, që përfitojnë bursa financiare si dhe mbështetje financiare	X2	Fonde grant për mësimdhënie në IAL publike, shpenzime për bursa financiare për studentët. Fondet grant detajohen me Vendim të Bordit të Administrimit
001	11	1011136	08	09450	2310000	3737	M1126 92	Projekte për zhvillimin institucional	X3	Fonde_Për Projekte për zhvillimin institucional
001	11	1011136	08	09770	2310000	3737	M1127 00	Fonde Granti për projekte të punës kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese	X4	Fonde Granti i punës kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese
<b>Totali</b>									<b>Tot=x1+x2+x3+x4</b>	